Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Naser Fejzullahu	**02.08.2023**	**07.08.2023**	**2023/0532**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me d Datën: 31.07.2023, **" Inovix " SH.P.K.** ka parashtruar ankesë me **Nr: 532/2023** , kundër Njoftim Vendimit mbi dhënien të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Badimetria (Matja e volumit te ujit), analiza e sendimenteve per 6 Digat** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedura t? hapur, lloji i kontratës: **Shërbime, vlera** e parashikuar e kontratës**: 950.000.00 € vlere e madhe.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë 12.05.2023, data e hapjes së ofertës 24.07.2023, data e njoftimit për pezullim te Aktivitetit te Prokurimit **ka pezulluar tenderin 01.08.2023.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË

KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 58 Hapja e Tenderëve

Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Neni 109 Afatet për Dorëzimin e Ankesës

Rregullore Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik Neni 25 Kriteret e përzgjedhjes

Neni 27 Kriteret e Dhënies së Kontratës Neni 61 Pezullimi i aktivitetit të prokurimit

Deklaratedetalembifaktetdheargumentet

Autoriteti Kontraktues pasi qe Nuk ka respektuar Pezullimin e procedures sipas Rregullors 001/2022 Neni 61 Paragrafi 1,duke bere nje shkelje substaciale te dispozitave te LPP-se nga Zyrtari Pergjegjes i Prokurimit, atehere pretendimet ankimore te parashtruara ne kerkesen per rishqyrtim tani me jane te rendit te dyte te paraqitura dhe ne ankese.

Kekrojme nga eksperti shqyrtues i OSHP-se te trajtoj si pretendim ankimor piken e pare te ankeses sepse ehste shkleje serioze nga ZPP dhe pastaj pretednimet ankimore qe kane te bejne me kekresat dhe kriteret e dosjes se tenderit respektivisht kerkesat e perzgjedhjes apo kualifkimit qe ajne idendike me ato te dhenies se tenderit dhe po ashtu kriteret e dhenies jane te pa matshme dhe jo objektive per menyre se si do poentohet Operatoret ekonomik.

Kriteret e përzgjedhje te përcaktuara ne njoftim për kontrate dhe doje te tenderit respektivisht te Kapaciteti teknike dhe profesional janë te njëjta apo identike edhe te kriteret e dhënies se kontratës apo nen kriteret bazuar ne kriterin Ekonomikisht me te favorshëm përveç çmimit.

Për me shume ju lutem referojuni FDT:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërk*
1. OE duhet të dëshmoj realizimin e kontratave të natyrë së ngjashme për periudhën e shkuar 5 vjeçare (nga dita e publikimit te njoftimit per kontrate). Kontratat duhet të jenë e natyrës së ngjashme në fushën e matjeve gjeodezike dhe vlerësimit gjeologjik në diga. Vlera minimale e të paktën një kontratë të ngjashme duhet të jetë gjithsejt 1,000,000.00 euro. Ndersa ne 5 vitet e fundit OE duhet te kete te realizuar edhe minimum nje kontrate te natyres se njejte (matje të badimetrisë) minimum ne vleren prej 100,000.00 euro.	1. Listën me të c kontratat kryesc shërbimeve të re 5 vjeçare nga da kontratë, duke s përfshira, shum pranuesin si dhe pranimit të shër sipas kërkesave.
Lista e stafit profesional të nevojshëm për realizimin e këtij projekti duhet të përfshijë minimalisht stafin e mëposhtëm kyq Menaxher i Projektit (1 pozitë) • Msc. Ing. i Gjeodezisë, Msc. Ing. Ndërtimtarisë (Hidroteknikë) apo Msc. Ing. Gjeolog, përgjegjës për menaxhimin dhe organizimin e punimeve të projektit në tërësi, me një përvojë minimum 10 vjeçare në fushat përkatëse.	OE duhet te ofr Projektit • K • CV e nër punës ose parak noterizuar), Ref sherbime të ngja
Ekspertë Kryesorë Dy Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master në Hidroteknikë me eksperience 5 vjeçare	Kopja e diplomë nënshkruar, • K parakontrate pe Referencë nga p ngjajshme.
Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master në Hidroteknikë me eksperience 5 vjeçare.	Kopja e diplomë nënshkruar, • K parakontrate pe Referencë nga p ngjajshme.

Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master në Hidroteknikë me eksperience 5 vjeçare.	Kopja e diplomës e n nënshkruar, • Kont parakontrate per pr Referencë nga punëd ngjajshme.
Gjeolog Një Inxhinier i Diplomuar i Gjeologjisë ose Master në Hidrogjeologji dhe Gjeologji Inxhinierike me eksperience 5 vjeçare.	Kopja e diplomës e n nënshkruar, • Kont parakontrate per pr Referencë nga punëd ngjajshme.
Hidrogjeolog Një Inxhinier i diplomuar në Gjeologji ose Master në Hidrogjeologji dhe Gjeologji Inxhinierike e eksperience 5 vjeçare.	Kopja e diplomës e n nënshkruar, • Kont parakontrate per pr Referencë nga punëd ngjajshme.
Eksperti i Erozion Një Inxhinier i diplomuar i Pylltarisë ose Master në Inxhinieri të Pylltarise me eksperience 5 vjeçare.	Kopja e diplomës e n nënshkruar, • Kont parakontrate per pr Referencë nga punëd ngjajshme.
Eksperti per Vegjetacion dhe Shfrytezimin e tokes Një Inxhinier i diplomuar i Pylltarisë ose Master në Inxhinieri të Pylltarie, me eksperience 5 vjeçare.	Kopja e diplomës e n nënshkruar, • Kont parakontrate per pr Referencë nga punëd ngjajshme.
Ekspert i Gjeofizikes NjëInxhinier i diplomuar në Gjeologji ose Master në Gjeofizike	Kopja e diplomës e n nënshkruar, • Kont

dhe Gjeologji Inxhinierike, me eksperience 5 vjeçare.	parakontrate per pro Referencë nga punëd ngjajshme.
Eksperti i GIS Një Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë ose Master i Gjeodezisë (Njëri të jetë i licensuar në GIS), me eksperience 5 vjeçare.	Kopja e diplomës e n nënshkruar, • Kontr parakontrate per pro Referencë nga punëd ngjajshme.
Ekspertë Ndihmës Inxhinier për përpunim të hartat hidrografike dhe topografike Një Inxhinjer i Diplomuar i Gjeodezise ose Master në Gjeodezi, me eksperience 5 vjeçare dhe Një Inxhinier Gjeolog , i Diplomuar i Gjeologjisë ose Master në Hidrogjeologji me eksperience 5 vjeçare.	Kopja e diplomës e n nënshkruar, • Kontr parakontrate per pro Referencë nga punëd ngjajshme.
Lista e pajisjeve per realizimin e ketij projekti a) Një paisje për matje batimetrike echosounder singlebeam. b) Një paisje për matje batimetrike echosounder multibeam. c) Një dron profesional fotogrametrik gjeodezi dhe softwere droni per teren. d) Një dron me sensor Lidar dhe softwere per perpunimin e matjeve nga droni. e) Një profilizues i shpejtësisë së zërit që funksionon me modulimin e frekuencës me brez të gjerë (FM) duke përdorur teknologjinë CHIRP të spektrit të plotë, i pajisur me konfigurim të dyfishtë transduktor 2-16 kHz dhe mbështet transmetimin e të dhënave Ethernet f) Një sensor shumëparametër për masat oqeanografike g) Katër paisje GPS GNSS h) Dy paisje stacion total i) Dy mjete transporti ujor j) Katër vetura tereni	OE duhet te dorezoj nenshkruar dhe vulo pajisjet, operatori ek dëshminë mbi pronës dëshminë mbi huazin cekura.

Kriteret e dhënies se kontratës:

ose

☒ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

	Nënkriteret	Ko
1	(a) Eksperienca profesionale e OE • Experience ne projekte te natyres se njejte [60%]. • Experience ne regjion [20%] • Struktura, organizimi dhe kapacitetet e Konsulentit [20%]	
2	(b) Kualiteti I metodologjise se propozuar per kete project. • Te kuptuarit e projektit [20%] • Qasja dhe metodologjia [50%] •Plani dinamik dhe ekipi I projektit [30%]	
3	(c) Oferta Financiare	
4	(a) Kualifikimi I Key Experteve • Menaxheri [30%] • Ekspertë Kryesorë Dy Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master në Hidroteknikë me eksperience 5 vjeçare [20%] • Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master në Hidroteknikë me eksperience 5 vjeçare. [10%] • Gjeolog Një Inxhinier i Diplomuar i Gjeologjisë ose Master në Hidrogjeologji dhe Gjeologji Inxhinierike me eksperience 5 vjeçare. 10%] •	

Hidrogjeolog Një Inxhinier i diplomuar në Gjeologji ose Master në Hidrogjeologji dhe Gjeologji Inxhinierike e eksperience 5 vjeçare. [10%] • Eksperti i Erozion Një Inxhinier i diplomuar i Pylltarisë ose Master në Inxhinieri të Pylltarise me eksperience 5 vjeçare. • Eksperti per Vegjetacion dhe Shfrytezimin e tokes Një Inxhinier i diplomuar i Pylltarisë ose Master në Inxhinieri të Pylltarie, me eksperience 5 vjeçare. [5%] • Ekspert i Gjeofizikes NjëInxhinier i diplomuar në Gjeologji ose Master në Gjeofizike dhe Gjeologji Inxhinierike, me eksperience 5 vjeçare. [5%] • Eksperti i GIS Një Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë ose Master i Gjeodezisë (Njëri të jetë i licensuar në GIS), me eksperience 5 vjeçare. [5%] • Ekspertë Ndihmës Inxhinier për përpunim të hartat hidrografike dhe topografike Një Inxhinjer i Diplomuar i Gjeodezise ose Master në Gjeodezi, me eksperience 5 vjeçare dhe Një Inxhinier Gjeolog , i Diplomuar i Gjeologjisë ose Master në Hidrogjeologji me eksperience 5 vjeçare. [5%] Secili nga Key-Expertet te listuar me lart do te vleresohen si vijon • Kualifikimet e pergjithshme [10%] • Eksperienca specifike dhe ekspertiza ne lidhje detyrat e tyre [80%] • Experience ne regjion [10%]

Dispozitat lartpërmendura përveç qe ndalojnë qe kriteret përzgjedhjes dhe dhënies/nen kriteret te jene te njëjta, por duhet te jene te ndryshme sepse kriteret e para janë kualifikuese kalon apo nuk kalon, ndërsa te dhënies janë për shpërblim me kontrate ne baze te pikëve te fituara kur kriteret janë te matshme dhe objektivë.

Ne ketë dosje përveç shkeljes se pare te kritereve te njëjta një shkelje substanciale janë KRITERET E PA MATSHME DHE JO OBJEKTIVE, sepse nuk ka një prag minimal deri maksimal se si tenderuesit gjate fazës se ofertimit mund te arrijnë piket pra nuk ka një tavan.

Ne baze këtij formulimit përveç çmimit te ofruar qe OE mund te dijen piket e fituara ne baze te procesverbalit te hapjes te gjitha nen kriteret e dhënies se kontratës janë pa matshme ne tërësi dhe diskriminuese per secilin OE sepse asnjë OE nuk mund te dij ne asnjë rast sa pike do i fitoj ne raport me tenderesuti tjerë.

Kërkojmë nga Zyra e prokurimit qe shkeljet substancialë te LPP-se te cekura me larte dhe te cilat janë te pa përshtatshme për te përcaktuar tenderin ekonomkiksivht te favorshëm te veprohet sipas Nenit 27 Kriteret e Dhënies së Kontratës paragrafi 27.7 Kur bëhet dhënia e kontratës në bazë të kriterit "tenderi ekonomikisht më i favorshëm", dosja e tenderit dhe, nëse aplikohet, njoftimi për kontratë duhet të deklarojë të gjitha kriteret (në një mënyrë objektive dhe të matshme) që aplikohet në procesin e dhënies, dhënia e peshëve relative (në kushte monetare) të përcaktuara për secilin kriter. Ato duhet të para-vendosen dhe të bëhen të ditura për tenderuesit. Kritere të reja ose të amandamentuara nuk duhet të prezantohet gjatë procedurës së dhënies së kontratës. Nëse autoriteti kontraktues gjatë procedurës së prokurimit kupton që kriteret e përdorura janë të papërshtatshme për të përcaktuar tenderin ekonomikisht më të favorshëm, përmirësimi i vetëm i situatës është anulimi i procedurës dhe tenderi" te BËJ ANULIMIN E PROCEDURES SE PROKURIMIT si zgjidhje e vetme sepse Kritere të reja ose të amandamentuara nuk duhet të prezantohet gjatë procedurës së dhënies së kontratës.

Te bashkangjitura te gjitha deshmite nga sistemi e-prokurimit.

Kriteret e përzgjedhje te përcaktuara ne njoftim për kontrate dhe doje te tenderit respektivisht te Kapaciteti teknike dhe profesional janë te njëjta apo identike edhe te kriteret e dhënies se kontratës apo nen kriteret bazuar ne kriterin Ekonomikisht me te favorshëm përveç çmimit.

KRITERET PËR VLERËSIM

Tenderi i përgjegjshëm **ekonomikisht më i favorshëm** i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6

	Nënkriteret	**Koeficient**
1	**(a) Eksperienca profesionale e OE • Experience ne projekte te natyres se njejte [60%]. • Experience ne regjion [20%] • Struktura, organizimi dhe kapacitetet e Konsulentit [20%]**	**20**
2	**(b) Kualiteti I metodologjise se propozuar per kete project. • Te kuptuarit e projektit [20%] • Qasja dhe metodologjia [50%] • Plani dinamik dhe ekipi I projektit [30%]**	**50**
3	**(c) Oferta Financiare**	**15**

4	**(a) Kualifikimi I Key Experteve • Menaxheri [30%] •Ekspertë Kryesorë Dy Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master në Hidroteknikë me eksperience 5 vjeçare [20%] • Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master në Hidroteknikë me eksperience 5 vjeçare. [10%] • Gjeolog Një Inxhinier i Diplomuar i Gjeologjisë ose Master në Hidrogjeologji dhe Gjeologji Inxhinierike me eksperience 5 vjeçare. 10%] • Hidrogjeolog Një Inxhinier i diplomuar në Gjeologji ose Master në Hidrogjeologji dhe Gjeologji Inxhinierike e eksperience 5 vjeçare. [10%] • Eksperti i Erozion Një Inxhinier i diplomuar i Pylltarisë ose Master në Inxhinieri të Pylltarise me eksperience 5 vjeçare. • Eksperti per Vegjetacion dhe Shfrytezimin e tokes Një Inxhinier i diplomuar i Pylltarisë ose Master në Inxhinieri të Pylltarie, me eksperience 5 vjeçare. [5%] • Ekspert i Gjeofizikes NjëInxhinier i diplomuar në Gjeologji ose Master në Gjeofizike dhe Gjeologji Inxhinierike, me eksperience 5 vjeçare. [5%] • Eksperti i GIS Një Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë ose Master i Gjeodezisë (Njëri të jetë i licensuar në GIS), me eksperience 5 vjeçare. [5%] • Ekspertë Ndihmës Inxhinier për përpunim të hartat hidrografike dhe topografike Një Inxhinjer i Diplomuar i Gjeodezise ose Master në Gjeodezi, me eksperience 5 vjeçare dhe Një Inxhinier Gjeolog , i Diplomuar i Gjeologjisë ose Master në Hidrogjeologji me eksperience 5 vjeçare. [5%] Secili nga Key-Expertet te listuar me lart do te vleresohen si vijon • Kualifikimet e pergjithshme [10%] • Eksperienca specifike dhe ekspertiza ne lidhje detyrat e tyre [80%] • Experience ne regjion [10%]**	**15**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Nuk ka raport te vlersimit se eshte pezulluar rasti me ankes ne OSHP.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

ka intereso juridiko material sipas nenit 4.1.26.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" Inovix " SH.P.K.**

Pretendimi 1

Autoriteti Kontraktues pasi qe Nuk ka respektuar Pezullimin e procedurës sipas Rregullores 001/2022 Neni 61 Paragrafi 1,duke bere një shkelje substaciale te dispozitave te LPP-se nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, atëherë pretendimet ankimore te parashtruara ne kërkesën për rishqyrtim tani me janë te rendit te dyte te paraqitura dhe ne ankese.Kërkojmë nga eksperti shqyrtues i OSHP-se te trajtoj si pretendim ankimor piken e pare te ankesës sepse është shkleje serioze nga ZPP

Përgjigjeje ne pretendimin 1

AK –ja i Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor nuk e ka respektuar nenin 108A pasi kërkesa për rishqyrtim lidhur me kriteret qe është bere nga OE ankues "INOVIX shpk " ka qene e bazuar dhe ne përputhje me nenin 108A. Ne baze te pretendimeve ankimore qe është bere ne kërkesën për rishqyrtim kriteret e dosjes se tenderit kriteret minimale për kualifikim (kriteret e përzgjedhjes) nuk përdorën si kritere në procesin e dhënies së kontratës ne këtë tender janë kritere te njëjta qe këto kritere vlerësohen si kritere kalon/nuk kalon. Duke u bazuar ne kritere te dhënies se kontratës te dosjes se tenderit nga AK-ja vetëm kriteri i metodologjisë mundet cilësohet si kriter për dhënien e kontratës dhe qe nuk është i njëjtë me kriteret e përzgjedhjes.

Ne mbas te rregullores për prokurim publik neni 25 kriteret e përshtatshmërish dhe kërkesat minimale për kualifikim te gjitha këto konsiderohen si kritere te përzgjedhjes, kërkesa e përzgjedhjes janë kërkesa qe OE duhet ti plotësojnë për te konsideruar i kualifikuar dhe atëherë kur te behet vlerësimi i kritereve te përzgjedhjes OE qe konsiderohen te kualifikimit.

Këto dokumente te kualifikimit, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të

mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese te OE qe dëshirojnë me konkurruar ne tender,AK duhet të përcaktoj në Dosje të Tenderit kriteret objektive dhe jo-diskriminuese.

Ne kete rast kur AK-ja shpall tender ne baze te kriterit "tenderi ekonomikisht më i favorshëm", duhet te jen të gjitha kriteret në një mënyrë objektive dhe të matshme dhe nuk duhet te jen te njëjta me kriteret e përzgjedhjes, kriteret që aplikohet per dhënie, dhënia e peshave të përcaktuara për secilin kriter duhet te jete e matshme ato duhet të vendosen ne dosjen e tenderit dhe të bëhen të ditura për tenderuesit.

Ne baze te rregullores për prokurim publik kur përzihen/perseriten kriteret për dhënie dhe kriteret e përzgjedhjes ose nuk janë caktuar kriteret mire si kritere te matshme atëherë procedura e prokurimit duhet te anulohet.

Një shembull qe unë mendoj se si duhet te jene kriteret e matshme duke u bazuar ne tenderin e njëjtë te Ministrisë se Mjedisit, ne e kemi mësuar neper trajnime se bashku me koleget e Ministres se Mjedisit:

1Përvoja specifike e kaluar në punë me projektim, projektim dhe teknik specifikimet e NDËRTESAVE të ngjashme:	Pikat 20
2 Përshtatshmëria e planit të propozuar të punës dhe metodologjinë në përgjigje te Termat e Referencës.	Pikat 30
Ky kriter do të vlerësohet si më poshtë: a) Qasja dhe Metodologjia Teknike Shumë mirë 100%, Mirë 90%, E kënaqshme 70%, e dobët 40%	0 - 15
b) Plani i punës- Rëndësia për TOR Shumë mirë 100%, Mirë 90%, E kënaqshme 70%, e dobët 40%)	0-10
c) Organizimi dhe stafi Shumë mirë 100%, Mirë 90%, E kënaqshme 75%, e dobët 40%)	0-5

3) Kualifikimet dhe kompetencat e stafi kyç për detyrën	Piket 50
a) Kualifikimet e përgjithshme	0-15
b) Përshtatshmëria për projektin	0-25
c) Përvojë në rajon	0-10
Gjithsej	100 pikë
Nota minimale e nevojshme për të kaluar:	**75 pikë (gjithsej)**

Ne baze te kësaj qe unë si ekspert i kam elaboruar besoj se pretendimet ankimore lidhur me pezullimin e aktivitetit te prokurimit kane qene te bazuar pasi kriteret e përzgjedhjes dhe kriteret për dhënie kane qe te njëjta dhe jo te matshme dhe kërkesa për rishqyrtim është dashur te kthehet e bazuar nga AK-ja dhe te shtyhet aktiviteti i prokurimit e te korrigjohen kriteret.

Pretendimi 2

Ne ketë dosje përveç shkeljes se pare te kritereve te njëjta një shkelje substanciale janë KRITERET E PA MATSHME DHE JO OBJEKTIVE, sepse nuk ka një prag minimal deri maksimal se si tenderuesit gjate fazës se ofertimit mund te arrijnë piket pra nuk ka një tavan.

Ne baze këtij formulimit përveç çmimit te ofruar qe OE mund te dijen piket e fituara ne baze te procesverbalit te hapjes te gjitha nen kriteret e dhënies se kontratës janë pa matshme ne tërësi dhe diskriminuese për secilin OE sepse asnjë OE nuk mund te dij ne asnjë rast sa pike do i fitoj ne raport me tenderesuti tjerë.

Kërkojmë nga Zyra e prokurimit qe shkeljet substancialë te LPP-se te cekura me larte dhe te cilat janë te pa përshtatshme për te përcaktuar tenderin ekonomkiksivht te favorshëm te veprohet sipas Nenit 27 Kriteret e Dhënies së Kontratës paragrafi 27.7 Kur bëhet dhënia e kontratës në bazë të kriterit "tenderi ekonomikisht më i favorshëm", dosja e tenderit dhe, nëse aplikohet, njoftimi për kontratë duhet të deklarojë të gjitha kriteret (në një mënyrë objektive dhe të matshme) që aplikohet në procesin e dhënies, dhënia e peshave relative (në kushte monetare) të përcaktuara për secilin kriter.

Përgjigjeje ne pretendimin 2

Kriteret nuk kane qene te përcaktuar mire ne dosjen e tenderit sipas ligjit te prokurimit dhe sipas rregullores dhe Udhëzuesit .

Separi ne baze te ligjit te prokurimit nuk duhet te përzihen kriteret nga AK-ja po e citojm nenin:

4. Autoriteti kontraktues duhet të sigurojë që të bëje një dallim të qartë në mes kritereve

të paragrafit 3. të këtij neni dhe kritereve të përzgjedhjes në lidhje me aftësitë e përgjithshme profesionale, financiare dhe teknike të themeluara në bazë të nenit 51 të këtij ligji dhe se nuk ka përsëritje të këtyre dy kategorive të kritereve.

3. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike.

Ndërsa ne baze te rregullores per Prokurim publik nenit 27.3 po e citojm:

27.3 Nëse kriteri është 'tenderi ekonomikisht më i favorshëm', kontrata duhet ti jepet tenderit i cili më së miri përmbushë kriteret relevante. Përveç çmimit AK mund të përfshijë kritere tjera relevante për lëndën e kontratës, siç janë:

a. Karakteristikat e cilësisë

b. Kostot Operative, të mirëmbajtjes dhe kosto tjera të jetë-gjatësisë

c. Karakteristika funksionale, teknike, mjedisore, estetike ose të ngjashme

d. Shërbimi i pas-shitjes dhe asistencës teknike

27.4 Kriteret duhet të përcaktohen me peshë sipas rëndësisë relative

Nëse e shikon nenin 52 te Ligjit qe i kam cituar me lart dhe neni 27 te Rregullore tregon qarte se kriteret nuk duhet te jene te njëjta për vlerësim nëse tenderi është ekonomikisht me i favorshëm shikoni qysh i parasheh ligji dhe rregullorja përveç çmimit duhet te jene cilësia, mirëmbajtja karakteristikat funksionale , teknike e tjera .

Gjithashtu sipas ekspertit shqyrtues kriteret duhet te pasqyroj tregun matshëm ne rajone sa i përmbushin edhe OE kriteret e dhënies pra mos te behet diskriminim dhe te jen te lidhura me natyrën e lendes se kontratës.

Kriteret duhet të shprehen me peshat dhe formulën e përdorur për dhënien e pikëve në mënyrë të qartë dhe të saktë, në mënyrë që tu mundësohet OE-ve të dorëzojë oferta duke pasur njohuri të sakta për nevojat e AK-së dhe rregullat që duhet të zbatohen për vlerësimin e një tenderi. Vetëm në këtë mënyrë garantohet parimi i trajtimit të barabartë dhe transparencës së plotë.

Sa i përket këtij pretendimi disa gjera janë te sqaruar edhe ne përgjigjeje ne pretendimin pretendimin 1 dhe ky pretendim është i bazuar.

Përgjigje ne pretendim e nenit 7

Shkelje e Nenit 7, Barazia ne Trajtim / Jo-Diskriminimi. Autoriteti kontraktues me rastin e shpalljes se Njoftimit për kontrate dhe dosjes se tenderit ka vendosur kritere diskriminuese, duke u bazuar ne këto te cekura me larte mendojmë se kriteret janë kërkuar ne maksimumin e mundshëm dhe kjo shifet se është bere kufizim i konkurrencës e nuk duhet te neglizhuar kriterin e dosjes se tenderit qe te përgatiten kritere sa me profesional për te ushtruar

veprimtarinë profesionale për ofrimin e shërbimeve te natyrës se njëjtë si qe ka kërkuar AK.

Info për panelin e OSHP-se.

Kriteri ekonomiko financiar është kërkuar me shume se qe kërkohet me Ligjin e prokurimit publik te Kosovës pasi është kërkuar me shume se 1.5 here .

Buxheti është 950.000.00 €

Qarkullim është kërkuar 1,920.000.00 €

1.5 here i bien me kane buxheti 1,425.000.00 €

Shikoni qysh është me Ligj citat:

Në përcaktimin e qarkullimit minimal, autoritetet kontraktuese nuk duhet të kalojnë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesa për qarkullim duhet të shprehet detyrimisht në shifra dhe duhet ti referohet maksimum tri viteve të fundit financiare. Vitet e tilla financiare duhet të përcaktohen qartë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tender ose pjesëmarrje. Kur, përveç qarkullimit minimal, një qarkullim i caktuar minimal në fushat specifike të mbuluara nga kontrata është i nevojshëm, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Ne baze te kësaj eksperti shqyrtues mendon se AK-ja ka tejkaluar limitet e përcaktuar me ligj dhe rregullore dhe duhet te anulohet aktivitetit i prokurimit pasi probabiliteti i përshtatjes se kritereve dhe buxheti mundet te konsiderohet i madh për përshtatje te kritereve nga AK-ja.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet aktiviteti i prokurimit -njoftimit për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" Inovix " SH.P.K.**

Naser Fejzullahu